EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8092
E enjte, 10 korrik 2025
Çmimi 0. 50 €

PDK-ja zyrtarizon rikandidimin e Shaqir Totajt për kryetar të Prizrenit

FAQE 5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJË MUAJ PARABURGIM PËR POLICËT, KËRKOHET DORËHEQJA E SVEÇLËS PAS VDEKJES SË TË RIUT NGA LIPJANI

FAQE 5

Pesë policë të Kosovës të mërkurën kanë dalë para drejtësisë lidhur me dyshimet për përfshirje në një ndërhyrje e cila ka përfunduar me vdekjen e të riut Agon Zejnullahu. Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e një muaji paraburgim për pesë zyrtarët policorë. Derisa politika dhe shoqëria civile kanë kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie për policët e arrestuar, avokati Besnik Berisha ka theksuar se ata "nuk janë fajtorë" dhe se kanë vepruar "në përputhje" me kompetencat e tyre ligjore. Lidhur me këtë rast tragjik, PDK-ja ka kërkuar dorëheqjen e ministrit në detyrë të MPB-së, Xhelal Sveçla

DËSHTON EDHE PËRPJEKJA E 44-t PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

F. 5

VENDIMI PËR RASTIN "VETERANËT" SHPALLET MË 14 KORRIK

F. 3

AKTUALE

SKANDALOZE: DALIN KOMUNIKIMET E NAZIM BLLACËS ME SHEFEN E HETIMEVE TË PROKURORISË NË HAGË

F. 3

GJYKATA E OBLIGON KGJK-në T'IA PAGUAJË LIMAJT MBI 57 MIJË EURO PËR QËNDRIMIN PA TË DREJTË NË PARABURGIM DHE ARREST SHTËPIAK

F. 6

KOSOVA NDAN 580 MIJË EURO PËR SHKOLLËN E MUZIKËS DHE MUZEUN E PRESHEVËS

F. 7

EKONOMI

QEVERIA NDAN MBI 5 MILIONË EURO PËR ZHVILLIM RAJONAL, KULTURË DHE PUNËSIM

F. 8

DHTIK-u I KËRKON AVOKATIT TË POPULLIT NISJEN E HETIMIT PËR BLLOKADËN E AUTOMJETEVE TË BIZNESEVE

F. 8

SPORT

NIS EVROPIANI I ESPORTS NË KOSOVË, KURTI: NGJARJE E MADHE, TA MBËSHTESIM ME ZEMËR EKIPIN TONË

F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Von der Leyen: T'i ulim kostot e energjisë dhe ta ndalojmë gazin rus

BRUKSEL, 9 KORRIK - Kostot e energjisë vazhdojnë të përfaqësojnë një disavantazh konkurrues për Evropën dhe kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme të rriten investimet në rrjete, në ndërlidhje dhe në sistemet e magazinimit, ka thënë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Ajo ka treguar se është koha që ta mbyllin rubinetin e gazit rus. "Është thelbësore ta zbatojmë plotësisht planin tonë të veprimit për energji të përballueshme dhe ta përmbushim angazhimin tonë për t'i hequr gradualisht importet e gazit dhe naftës ruse deri në fund të vitit 2027. Është koha ta mbyllim rubinetin dhe t'i japim fund epokës së karburanteve fosile ruse në Evropë përgjithmonë", ka thënë ajo.

Trumpi e akuzon Putinin se flet 'budallallëqe' për Ukrainën

UASHINGTON, 9 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump e ka akuzuar homologun rus, Vladimir Putin, se flet "budallallëqe" për Ukrainën, dhe është zotuar se Shtetet e Bashkuara do të dërgojnë më shumë armë për Kievin që ta mbrojë veten kundër pushtimit rus. Në deklarimet e tij për medie, Trumpi është shprehur i zemëruar me liderin e Kremlinit për çështjen e luftës së nisur nga Moska gati tre vjet e gjysmë më parë. "Putini na godet me shumë budallallëqe, nëse dëshironi ta dini të vërtetën. Ai është shumë i mirë gjatë gjithë kohës, por kjo rezulton pa ndonjë kuptim", u ka thënë Trumpi gazetarëve pas një takimi të kabinetit në Shtëpinë e Bardhë.

Trumpi e ka përsëritur se është "shumë i pakënaqur" me Putinin prej bisedës së tyre të fundit javën e kaluar që nuk ka rezultuar me përparim drejt një marrëveshjeje për dhënie fund të luftës.

I pyetur për interesimin e tij në një projektligj të Senatit për më shumë sanksione ndaj Rusisë, Trumpi ka thënë se është duke e vëzhguar me shumë interesim.

Kritikat e Trumpit ndaj Putinit kanë ardhur një ditë pasi ai ka thënë se do të dërgojë më shumë armë në Ukrainë, duke përmbysur kështu një njoftim të Uashingtonit javën e kaluar se do t'i ndalë disa dërgesa armësh.

"Putini nuk është duke i trajtuar siç duhet njerëzit. Ai është duke vrarë shumë njerëz, prandaj ne do të dërgojmë armë për mbrojtje dhe unë e kam miratuar këtë", ka thënë Trumpi. Ai është zotuar për dërgim të menjëhershëm të 10 sistemeve Patriot në Ukrainë, sipas raportimeve të disa medieve amerikane.

Trumpi, po ashtu, i ka bërë thirrje shefit të Pentagonit, Pete Hegseth, që t'i nxisë kontraktorët ta rrisin prodhimin e armatimit.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Evropa Perëndimore përjetoi qershorin më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë

BRUKSEL, 9 KORRIK - Evropa Perëndimore e ka parë qershorin e saj më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë, ndërsa dy valë masive të nxehtësisë kanë përfshirë kontinentin, ka bërë me dije Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike Koperniku i BE-së. Temperaturat mesatare kanë arritur në 20.49 gradë celsius, mbi rekordin e mëparshëm prej 20.43 gradësh në vitin 2003. "Qershori 2025 pa një valë të jashtëzakonshme të nxehtësisë që ndikoi në pjesë të mëdha të Evropës Perëndimore, me pjesën më të madhe të rajonit që përjetoi stres shumë të fortë të nxehtësisë", ka theksuar Samantha Burgess nga Qendra Evropiane për Parashikime të Motit me Afat Mesëm (ECMWF), e cila drejton shërbimin e BE-së. "Kjo valë e nxehtësisë u bë më intensive

nga temperaturat rekord të sipërfaqes së detit në Mesdheun perëndimor. Në një botë që po ngrohet, valët e nxehtësisë ka të ngjarë të bëhen më të shpeshta, më intensive dhe të ndikojnë në më shumë njerëz në të gjithë Evropën", ka thënë ajo.

Globalisht, muaji qershor ishte i treti më i ngrohtë i regjistruar ndonjëherë, pas viteve 2023 dhe 2024, me temperatura mesatare të ajrit në sipërfaqe prej 16.46 gradësh. Raporti ka zbuluar se temperaturat e ajrit në qershor 2025 ishin mbi mesataren në pjesë të mëdha të Evropës perëndimore dhe qendrore.

Dy valë të forta të nxehtësisë goditën pjesë të mëdha të Evropës Perëndimore dhe jugore në mesin e qershorit dhe në fund të muajit. Një valë e jashtëzakonshme e nxehtësisë detare u zhvillua në Mesdheun perëndimor, duke çuar në temperaturën mesatare ditore të sipërfaqes së detit më të lartë të matur ndonjëherë në rajon, me 27 gradë celsius.

Gjykata e Bosnjës heq masën e paraburgimit për liderët e Republikës Sërpska

SARAJEVË, 8 KORRIK - Një gjykatë në Bosnjë-Hercegovinë ka hequr masën e paraburgimit për Radovan Vishkoviqin, kryeministër i Republikës Sërpska (RS), dhe për Nenad Stevandiqin, kryetar i parlamentit të RS-së, raporton Radiotelevizioni i Republikës Sërpska. Seanca është mbajtur të mërkurën, më 9 korrik, ku atyre u janë caktuar masa ndaluese, konkretisht detyrimi për t'u paraqitur çdo 14 ditë në organin kompetent të policisë, thuhet në njoftim.

Pak ditë më parë kjo gjykatë e kishte hequr masën e paraburgimit edhe për Millorad Dodikun, president i RS-së.

Prokuroria në Bosnjë-Hercegovinë kishte lëshuar në mars të këtij viti urdhër për shoqërimin e tyre nga policia gjyqësore. Sipas këtij urdhri, të tre akuzohen për kryerjen e veprës penale "sulm ndaj rendit kushtetues". Urdhri ishte lëshuar në ditën kur parlamenti i RS-së pritej të diskutonte për Draftin e Kushtetutës së re të RS-së, përmes së cilës autoritetet në këtë ent planifikojnë ta përcaktojnë RS-në si shtet të popullit serb, t'i japin të drejtë vetëvendosjeje, ta themelojnë ushtrinë e tyre dhe ta shfuqizojnë Këshillin e Popujve.

Kodi Penal i Bosnjë-Hercegovinës parasheh dënime deri në pesë vjet burgim dhe ndalim të ushtrimit të funksioneve zyrtare për këdo që "në mënyrë të paligjshme përpiqet ta ndryshojë rendin kushtetues të Bosnjë-Hercegovinës, apo t'i rrëzojë institucionet më të larta të saj".

Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese

në Bosnjë-Hercegovinë ka marrë një masë të përkohshme për pezullimin e zbatimit të Ligjit për Regjistrin e Posaçëm dhe transparencën e punës së organizatave jofitimprurëse. Kërkesa është paraqitur nga Kemal Ademoviq, nënkryetar i Dhomës së Popujve në Parlamentin e Bosnjë-Hercegovinës. Ky ligj, i miratuar nga Kuvendi i RS-së, sipas modelit të ligjit rus, vendos kontroll të rreptë mbi punën e sektorit civil në këtë entitet. Dodiku ka deklaruar se ligjet do të zbatohen pavarësisht këtij vendimi të gjykatës. Ligjet e fundit janë dënuar pothuajse unanimisht në arenën ndërkombëtare, nga sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, dhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, e deri te shumë ambasada të huaja në Bosnjë-Hercegovinë.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

VENDIMI PËR RASTIN "VETERANËT" SHPALLET MË 14 KORRIK

PRISHTINË, 9 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka shpallur të përfunduar procesin gjyqësor ndaj të akuzuarve në rastin e njohur si "Veteranët", duke caktuar 14 korrikun datë për shpalljen e vendimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve.
Në këtë rast të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare janë ish-kryeministri Agim Çeku, ish-ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ish-deputeti Shkumbin Demalijaj, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari, raporton "Betimi për Drejtësi".
Në seancën e së mërkurës palët kanë qëndruar pranë fjalës përfundimtare, ndërsa të akuzuarit kanë shfrytëzuar të drejtën për mbrojtje në heshtje.
Paraprakisht trupi gjykues ka aprovuar propozimet e mbrojtëses së të akuzuarit Ahmet Daku, avokates Kadina Bogaj-Thaqi, duke administruar si prova materiale pesë aktgjykime të Gjykatës Themelore në Gjilan, ku të akuzuar ishin veteranë e që ishin shpallur të pafajshëm. Si dhe listat e aplikacioneve që janë vendosur gabimisht nëpër zona operative.
Seancat e datës 20 maj dhe 2 korrik 2025 kishin dështuar të mbaheshin lidhur me këtë rast.
Më 28 prill 2025, kur pritej të bëhej shpallja e aktgjykimit, gjykata ka vendosur ta rihapë gjykimin edhe për një seancë.
Gjykata Themelore në Prishtinë më 16 prill 2021 të akuzuarit i kishte liruar nga akuza, por Gjykata e Apelit më 26 prill 2022 e ka kthyer në rigjykim këtë rast.
Sipas Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), të akuzuarit, duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, për kohën sa ishin pjesë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së, i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 88.769.217.04 eurosh.
Për këto akuza, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte marrë aktgjykim lirues edhe më 19 janar 2021. Aktgjykimi në këtë rast ishte përpiluar tre muaj më vonë, ku PSRK brenda 15 ditësh kishte pasur mundësi të ushtrojë ankesë ndaj këtij aktgjykimi.
Ndryshe, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 qershor 2019, e kishte konfirmuar aktakuzën

për këtë rast, ndërsa këtë vendim e kishte konfirmuar edhe Gjykata e Apelit në gusht të vitit 2019.
Me aktakuzën e PSRK-së, po ashtu, ishte kërkuar që Gjykata Themelore në Prishtinë, të urdhërojë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që të pezullojë pagesën e pensioneve për 19 500 veteranë deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Por, më 1 prill 2019, gjykata e kishte refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se propozimi për masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së si palë e tretë.
Kurse pas seancave të mbajtura, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 janar 2021, ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në këtë rast.
Sipas aktakuzës së përgatitur nga ish-prokurori special, Elez Blakaj, personat e përfshirë thuhet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës.
Në këtë aktakuzë janë përfshirë 12 persona të cilët ngarkohen me veprën penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar".
Listës së personave të akuzuar i prin Agim Çeku, i pasuar nga Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rrustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari.
PSRK-ja, po ashtu, i kishte propozuar gjykatës që ta lëshonte masën për ndalimin e pagesës së pensioneve të fituara në mënyrë të kundërligjshme si veteranë luftëtarë të UÇK-së deri në përfundimin e procedurës penale.
Më tutje, sipas PSRK-së, nga provat e siguruara ishte vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të UÇK-së, buxheti i Republikës së Kosovës ishte dëmtuar në shumë prej 68.153.533.14 eurosh. Ndërsa, me aktakuzën e dorëzuar në gjykatë më 7 dhjetor 2018, pretendohet se buxheti i Republikës së Kosovës ishte dëmtuar në shumën prej 88.769.217.04 eurosh.

SKANDALOZE: DALIN KOMUNIKIMET E NAZIM BLLACËS ME SHEFEN E HETIMEVE TË PROKURORISË NË HAGË

PRISHTINË, 9 KORRIK - Zdenka Pomper është koordinatore e hetimeve në Prokurorinë e Specializuar të Hagës. Dikur punonte në Kosovë, hetuese në EULEX. Pomper sa ishte në Kosovë del se e kishte trashuar muhabetin me figura kontroverse, me agjentë të BIA-s si Nazim Bllaca. Në emailet e publikuara nga "RTV Dukagjini", Bllaca dhe Pomper shkëmbejnë disa informacione. Megjithatë, gazetari Ermal Panduri ka paralajmëruar se ka biseda me orë të tëra mes Bllacës e Pomperit.
Në një prej emaileve Bllaca e njoftonte Pomperin për vdekjen e pretenduar të dëshmitarëve në rastin Limaj dhe Haradinaj në Tribunalin e Hagës. "Në procesin Limaj, Agim Zogaj vdiq, Daut Gashit iu montua bombë, ai është gjallë, ka pasur shumë presione ndaj dëshmitarëve. Ishim te disa dëshmitarë, dhe u thoshim a do të jetosh apo jo. Ne u thoshim nëse do të jetoni mos shkoni në Tribunal të Hagës", e njoftonte Bllaca, Pomperin.
Këtij emaili i ishte përgjigjur Pomperi. Madje ajo kishte shtruar edhe një pyetje: "A ka

pasur hetim special për të gjitha këto gjëra?".
Pesë minuta më vonë Pomperi ia kishte dërguar një email Bllacës, një link që tani nuk hapet, por Bllaca e kishte ruajtur në "lap-top"-in e vet. Aty janë disa vrasje, ku pretendohet se janë vrarë disa dëshmitarë në rastin Limaj dhe Haradinaj.
Skandalin e bën më të madh fakti se linku që Pomperi ia dërgon Bllacës janë raporte të Serbisë. Burimet i ka në raportet e Serbisë. Këtu pretendohet se 16 dëshmitarë janë vrarë.
Në këtë email të Pomperit janë dy raste, një veturë e djegur, në të dytën një person i vrarë. Krejt këto burimin del se e kanë pasur në Serbi, propaganda e tyre kundër UÇK-së. Pra, shefja e hetimeve e Prokurorisë së Hagës, flet me Nazim Bllacën, me burime të propagandave serbe.
Komunikimi kishte vazhduar edhe më tutje. Bllaca ia kishte dërguar një email, ku brenda ka fotografi. Ajo ia dërgon një falënderim Bllacës. "Faleminderit! Gjithmonë kam pyetur veten nëse dikush ka hetuar aksidentet, vrasjet e dëshmitarëve në rastin Limaj dhe Haradinaj".
Një tjetër email, Bllaca ia kishte nisur Pomperit. Ai frikësohet se dëshmitë e tij po zbulohen. "Kisha kontakt këtë mbrëmje, dhe më njoftoi një person për deklaratën time, dhe atë e kanë ditur vetëm katër persona. Si është e mundur të dihet kjo deklaratë jashtë këtyre? Ju lutem, ka pasur dhe ka rrjedhje të informacioneve. Sot dëgjova se kam dhënë deklaratë për një varrezë në kohën e luftës. Nga brenda në EULEX po dekonspirohen informatorët", shkruante Bllaca.
Bllaca ishte ankuar te Pomperi më pas për Sami Lushtakun dhe Sabit Gecin. Pomperi është një prej figurave kryesore të Prokurorisë së Hagës, e cila po heton dhe akuzon ish-krerët e UÇK-së. Ajo kishte qenë dëshmitare në rastin kundër Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit.

NJË MUAJ PARABURGIM PËR POLICËT, KËRKOHET DORËHEQJA E SVEÇLËS PAS VDEKJES SË TË RIUT NGA LIPJANI

Pesë policë të Kosovës të mërkurën kanë dalë para drejtësisë lidhur me dyshimet për përfshirje në një ndërhyrje e cila ka përfunduar me vdekjen e të riut Agon Zejnullahu. Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesën e prokurorisë për caktimin e një muaji paraburgim për pesë zyrtarët policorë. Derisa politika dhe shoqëria civile kanë kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie për policët e arrestuar, avokati Besnik Berisha ka theksuar se ata "nuk janë fajtorë" dhe se kanë vepruar "në përputhje" me kompetencat e tyre ligjore. Lidhur me këtë rast tragjik, PDK-ja ka kërkuar dorëheqjen e ministrit në detyrë të MPB-së, Xhelal Sveçla

EPOKA E RE **Lirim GECI**

PRISHTINË, 9 KORRIK - Pesë zyrtarë të Policisë së Kosovës janë paraqitur të mërkurën para Gjykatës Themelore të Prishtinës, dega Lipjan, për përfshirje në një ndërhyrje që ka përfunduar me vdekjen e 27-vjeçarit Agon Zejnullahu. Prokurorët kanë kërkuar paraburgim prej një muaji për pesë zyrtarët policorë. Kjo kërkesë është aprovuar nga Gjykata Themelore e Prishtinë, dega në Lipjan.

Duke folur për medie pas seancës dëgjimorë, avokati mbrojtës i njërit nga pesë policët e dyshuar, Besnik Berisha, ka thënë se ky është një rast "që ka tronditur secilin, por një rast që unë besoj se as nuk i kanë kontribuuar e as shkaktuar këta zyrtarë policorë". "Sot u kërkua masa e paraburgimit vetëm për një arsye, sepse raportet janë të acaruara mes palës së dëmtuar dhe zyrtarëve policorë të arrestuar", ka thënë Berisha.

Ai ka thënë se Policia e Kosovës "sot po etiketohet e sulmohet, madje padrejtësisht po linçohet, derisa mjekësia ende nuk ka folur dhe nuk dihet as shkaku i vdekjes e as kontributi në shkakun e vdekjes, aq më pak nuk dihet se cilat ishin substancat të cilat ishin në organizmin e tani të të ndjerit".

Berisha ka theksuar se zyrtarët policorë "nuk janë fajtorë" dhe se ata kanë vepruar "në përputhje" me kompetencat e tyre ligjore. "Ata kontribuuan për liri dhe drejtësi dhe vepruan ashtu siç janë të trajnuar, ashtu siç e kanë udhëzimin administrativ për përdorimin e forcës dhe u dolën në ndihmë qytetarëve të Lipjanit", ka thënë Berisha.

Rasti tragjik i Agon Zejnullahut ka ndodhur në orët e hershme të 7 korrikut në Lipjan, ndërsa në mbrëmje janë arrestuar pesë policët që janë marrë me rastin, nën dyshimet se kanë kryer veprën penale "vrasje nga pakujdesia". Policia ka thënë se i ndjeri, i identifikuar si Agon Zejnullahu, dyshohet se ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe, duke sulmuar automjete dhe kalimtarë, është ndaluar nga autoritetet e rendit.

Lidhur me këtë rast tragjik ka pasur reagime të shumta. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë thirrje për transparencë të plotë, përgjegjësi institucionale dhe drejtësi pa kompromis lidhur me rrethanat e vdekjes së Zejnullahut. Ndërsa kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar dhe ka thënë se pret "hetim të thellë dhe sa më të shpejtë që zbardh të vërtetën e plotë dhe i bën të njohura të gjitha rrethanat" e vdekjes së 27-vjeçarit. "Për këtë, bashkëpunimi ndërmjet Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Prokurorisë është thelbësor. Nuk do të ketë strehë në institucione apo nga institucionet për këdo që mund t'i tejkalojë kompetencat apo ta ketë shkelur ligjin gjatë detyrës zyrtare", ka deklaruar Kurti.

Duke komentuar reagimet publike për ngjarjen, ai ka thënë se "tendenca që të nisë një antifushatë ndaj policisë është e dëmshme dhe nuk është zgjidhje". "Thirrjet për drejtësi dhe përgjegjësi janë të drejta, por ato më së miri realizohen me rezultatet e plota të hetimeve, dhe një verdikt profesional në bazë të tyre", është shprehur Kurti.

Ndaj deklaratës së Kurtit për policinë ka reaguar deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku. Ajo i ka thënë Kurtit se, "për dallim prej teje, ne e kemi respektuar Policinë e Kosovës gjithmonë...". Ajo ka përmendur se si Lëvizja Vetëvendosje e kishte sulmuar me gurë policinë. "Për dallim prej teje, ne e kemi respektuar Policinë e Kosovës gjithmonë, si në qeveri ashtu edhe në opozitë. Ne i respektojmë institucionet pa kushte dhe pa kalkulime politike. Ti je ai që dikur ke hedhur gurë e mllef mbi policinë. Sot, ne nuk po kërkojmë asgjë më shumë përveç hetim profesional për rastin, dhe përgjegjësisë politike. Sa për respektin ndaj policisë, sikur ta kishe me të vërtetë, nuk do t'i lije pa këpucë e pa uniforma. Do t'ua kishe rritur pagat. Dhe mbi të gjitha, nuk do t'ua kishe shkurtuar trajnimet në vetëm tre muaj", ka shkruar ajo në "Facebook".

Kurse ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se hetimet janë duke u zhvilluar me intensitet maksimal dhe se kushdo që rezulton fajtor për vdekjen e të riut, do ta marrë dënimin e merituar.

Nga pamjet e shpërndara në medie, viktima duket me duar të lidhura dhe në gjunjë, ndërsa më pas bartet me autoambulancë. Familja ka deklaruar se është e zhgënjyer me mungesën e deritashme të transparencës nga autoritetet.

Vëllai i viktimës, duke folur për disa medie, ka thënë se familjarët nuk kanë marrë asnjë sqarim nga policia, ndërsa trupi i të ndjerit "ka pasur shumë shenja dhe thyerje".

PDK-ja kërkon dorëheqjen e Sveçlës nga MPB-ja pas vdekjes së Agon Zejnullahut

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, ka shprehur ngushëllime për vdekjen e 27-vjeçarit Agon Zejnullahu dhe ka kërkuar përgjegjësi nga organet e shtetit. Gruda në emër të PDK-së ka kërkuar edhe dorëheqjen e ministri në detyrë të Punëve të Brendshme (MPB), Xhelal Sveçla. "Kërkojmë përgjegjësi për këtë ngjarje tragjike që na tronditi të gjithëve. Në emër të PDK-së kërkoj dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, Xhelal Sveçla, si aktor i papërgjegjshëm politik dhe ligjor", ka thënë Gruda.

Dorëheqjen e Sveçlës e kanë kërkuar edhe përfaqësues të tjerë të partive politike, por edhe të shoqërisë civile.

DËSHTON EDHE PËRPJEKJA E 44-t PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

PRISHTINË, 9 KORRIK - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar për të dyzetekatërtën herë me radhë ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit.
Të mërkurën deputetët kanë refuzuar sërish ta formojnë një komision të propozuar për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës.
Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe kanë refuzuar sërish, në vazhdimin e seancës konstituive të mërkurën, që ta propozojnë një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë. Ato janë duke pretenduar se është jokushtetuese kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje, e cila ka fituar shumicën e votave në zgjedhje, që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë, ndërsa LV-ja është duke këmbëngulur se votimi i fshehtë është legjitim dhe kërkon të ecet përpara.
Seanca konstituive do të vazhdojë të premten e 11 korrikut.
Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve.
Por, procesi ka ngecur te pika e tretë, te zgjedhja e kryeparlamentarit.
Kandidatja e LV-së për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk ka arritur në disa votime të hapura t'i marrë 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në pozitë.
Haxhiu e LV-së konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit.
Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.
Më 26 qershor Gjykata Kushtetuese e Kosovës kërkoi nga deputetët ta konstituojnë Kuvendin brenda 30 ditësh, por nuk ka shpjeguar se çfarë mund të ndodhë në rast të mosrespektimit të aktgjykimit të saj.
Partitë politike vazhdojnë ta interpretojnë ndryshe-ndryshe atë. Javën e kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka ftuar në takim përfaqësuesit e partive politike për të diskutuar për opsionet për dalje nga kriza. Ajo e ka përmendur edhe mundësinë që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për sqarime shtesë.

MBI 3 600 NËNSHKRIME KUNDËR URAVE TË REJA NË MITROVICË

PRISHTINË, 9 KORRIK - Peticioni kundër ndërtimit të dy urave mbi lumin Ibër, për të cilat gurthemeli është vendosur në fillim të korrikut në prani të kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, është nënshkruar nga 3 628 qytetarë, ka njoftuar të mërkurën Lista Serbe. Sipas Qeverisë së Kosovës, ndërtimi i këtyre urave ka për qëllim t'i lidhë Mitrovicën e Veriut me shumicë serbe me Mitrovicën e Jugut, ku jeton shumica shqiptare.
Për ndërtimin e dy urave, një për këmbësorë dhe tjetra për komunikacion, Qeveria e Kosovës ka ndarë rreth tre milionë euro, ndërsa përfundimi i punimeve pritet në vjeshtë.
Megjithatë, Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon përkrahjen e Beogradit, ka nisur të hënën nënshkrimin e peticionit dhe të mërkurën ka njoftuar se nënshkrimet janë mbledhur "për 11 orë" dhe se peticioni është "përfunduar me sukses".
"Kjo shifër e nënshkrimeve për një kohë kaq të shkurtër paraqet një sinjal të fuqishëm dhe të qartë, se populli është kundër imponimit dhe politikës së forcës", është thënë në deklaratën e Listës Serbe.
Nuk dihet saktësisht numri i banorëve të Mitrovicës së Veriut aty ku janë mbledhur nënshkrimet pasi pjesëtarët e komunitetit serb në veri të Kosovës kryesisht e kanë bojkotuar regjistrimin e popullsisë në vitin 2024.
Agjencia e Statistikave e Kosovës ka vlerësuar se në katër komunat me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq - jetojnë rreth 20 mijë serbë.
Lista Serbe ka njoftuar se në ditët në vijim do ta dorëzojë peticionin te përfaqësuesit e vendeve të Quint-it, misionit të KFOR-it, EULEX-it, Bashkimit Evropian, OSBE-së dhe UNMIK-ut, duke kërkuar prej tyre një reagim "të menjëhershëm dhe të qartë", ndërprerjen e ndërtimit të urave pa konsultim me popullin serb dhe respektimin e parimeve bazë demokratike dhe të së drejtës ndërkombëtare.
"Populli serb nuk është kundër zhvillimit dhe infrastrukturës, por është kundër vendimeve që merren pa të dhe kundër një politike që ka për synim zhdukjen e tij nga këto hapësira", është thënë në reagimin e Listës Serbe.
Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", Bashkimi Evropian ka deklaruar se ndërtimi i dy urave të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë "ka rëndësi praktike dhe politike" dhe se çdo projekt infrastrukturor midis Mitrovicës së Veriut dhe asaj të Jugut kërkon koordinim të ngushtë dhe dialog mes të gjitha komuniteteve të përfshira.
"Është e domosdoshme që këto projekte ta pasqyrojnë vullnetin dhe nevojat e komuniteteve lokale", është thënë në përgjigje.
Urat e reja po ndërtohen pranë urës kryesore mbi Ibër, e cila është pjesë e Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes të arritur në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi. Kjo urë është e njohur për përplasjet etnike pas luftës dhe për këtë arsye është nën mbikëqyrjen e forcave të KFOR-it.
Aktualisht është e hapur vetëm për këmbësorë, ndërsa Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar hapjen e saj për komunikacion në korrik të vitit të kaluar, gjë që pati shkaktuar tensione dhe reagime nga bashkësia ndërkombëtare.
Kosova dhe Serbia kishin rënë dakord që ura të hapej për qarkullim në vitin 2014 në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve. Ishte paraparë revitalizimi i urës dhe largimi i të gjitha barrikadave të vendosura nga serbët lokalë.
Në vitin 2016 është dakorduar një plan i ri zbatimi për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet rreth interpretimeve të marrëveshjeve të mëparshme. Sipas këtij plani, ura duhej të hapej për komunikacion në janar të vitit 2017.
Punimet për revitalizim përfunduan në qershor të vitit 2018, ndërsa ura në të cilën janë investuar 1.5 milion euro nuk është hapur kurrë për automjete, por vetëm për këmbësorë.

PDK-ja zyrtarizon rikandidimin e Shaqir Totajt për kryetar të Prizrenit

Prizren, 9 korrik - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zyrtarizuar rikandidimin e Shaqir Totajt për kryetar të komunës së Prizrenit për zgjedhjet e 12 tetorit. Me këtë rast, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se prizrenasit do ta kenë shumë më të lehtë të vendosin për të ardhmen e tyre duke e votuar Totajn.
"Mbrëmë, në një atmosferë tepër pozitive dhe festive, mes shumë qytetarëve dhe aktivistëve, zyrtarizuam rikandidimin e Shaqir Totajt për kryetar të Prizrenit. Gjatë katër viteve të fundit, Shaqa, duke nderuar epitetet e Prizrenit si qytet 'historik' dhe 'kulturor', ia ka shtuar edhe dy të tjerë: 'i punës' dhe 'i zhvillimit'. Kudo që të lëvizësh nëpër komunën e Prizrenit, dallohen qartë rezultatet e përkushtimit dhe punës së tij dhe të ekipit të tij në shërbim të qytetarëve. Prandaj, më 12 tetor, prizrenasit do ta kenë shumë më të lehtë të vendosin për të ardhmen e tyre. Sepse me Shaqën, Prizreni është gjithmonë në punë!", ka theksuar Krasniqi.

GJYKATA E OBLIGON KGJK-në T'IA PAGUAJË LIMAJT MBI 57 MIJË EURO PËR QËNDRIMIN PA TË DREJTË NË PARABURGIM DHE ARREST SHTËPIAK

Prishtinë, 9 korrik - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka aprovuar pjesërisht padinë e Fatmir Limajt, duke e detyruar Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK) që, për shkak të privimit pa të drejtë nga liria (paraburgimi dhe arresti shtëpiak) në procesin penal për krime lufte, t'ia paguajë për dëmin jomaterial 48 mijë e 800 euro, për dëmin material 6 mijë e 216 euro dhe 150 euro të tjera në emër të shpenzimeve për pako ushqimore gjatë qëndrimit në paraburgim. Po ashtu, KGjK-ja obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguajë Limajt 2 48 euro, raporton "Betimi për Drejtësi".

Fillimisht, përmes avokatit Tahir Rrecaj, kryetari i Nismës Socialdemokrate, njëherësh deputeti Fatmir Limaj, kishte parashtruar padi më 13 korrik 2017, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jomaterial. Sipas vendimit, në padi paditësi Limaj ka deklaruar se për shkak të zbatimit të procedurës së padrejtë penale ndaj tij, në mënyrë të kundërligjshme ka qëndruar në paraburgim 85 ditë (nga 24 nëntori 2012 deri më 8 mars 2013) dhe në arrest shtëpiak 384 ditë.

Andaj, më 26 janar 2016, paditësi Limaj është thënë se i është drejtuar të padituruës KGjK-së, përkatësisht komisionit për kompensimin e dëmit personave të dënuar pa arsye dhe personave të hequr pa bazë nga liria, me kërkesë për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, por që nuk ishte arritur marrëveshja. Sipas vendimit, Limaj ka theksuar se për shkak të qëndrimit pa bazë ligjore në paraburgim dhe arrest shtëpiak, ka pësuar dëm material në formë të pagimit të shpenzimeve për avokat për mbrojtje penale. Aty thuhet se angazhimi deri në tre avokatë mbrojtës është e drejtë e secilit person të pandehur.

Më tutje është thënë se Limaj ka theksuar se ka pësuar dëme materiale si pasojë e angazhimit të dy avokatëve, përfshirë avokatin ndërkombëtar nga Mbretëria e Bashkuar, me shpenzimet e tij personale, gjatë një procesi penal kompleks dhe të padrejtë për krime lufte, në të cilin ishte shpallur i pafajshëm.

Për më tepër, në vendim është thënë se paditësi Limaj ka theksuar se ka pësuar dëme jomateriale të konsiderueshme, duke përfshirë dëmtim të reputacionit, vuajtje shpirtërore dhe dhimbje emocionale, të cilat u thelluan edhe më shumë me vdekjen e bashkëshortes së tij gjatë periudhës së arrestimit dhe paraburgimit, që zgjati 469 ditë (arrest shtëpiak dhe paraburgim).

Aty është thënë se procesi i zgjatur në të gjitha shkallët e gjyqësisë ka ndikuar në rënien e rëndë të imazhit dhe pozicionin politik të paditësit, e cila thuhet se u vërtetua edhe me rezultatet zgjedhore para dhe pas këtyre ngjarjeve.

Sipas padisë që ka ushtruar Limaj, përmes avokatit të tij, duke sqaruar çështjen e mbrojtjes së angazhuar në rastin konkret, potencon se materiali hetimor ishte jashtëzakonisht voluminoz, përfshirë rreth 87 dosje, ku për selektimin dhe përzgjedhjen e provave relevante u humbën tre muaj, duke u reduktuar në 19 dosje të rëndësishme për çështjen penale.

Gjithashtu, paditësi Limaj ka potencuar se gjatë 13 viteve të fundit është përballur me tri aktakuza për krime lufte, në gjykimet në Tribunalin e Hagës, në rastin Kleçka nga EULEX, dhe në rastin Bellanica, ku në të gjitha është shpallur i pafajshëm.

Krahas kësaj, Limaj ka shtuar se, përveç këtyre, janë zhvilluar edhe dy procedura penale në lidhje me rastin MTPH 1 dhe 2, për të cilat është shpallur i pafajshëm.

Andaj me këto procese Limaj ka potencuar se u është nënshtruar proceseve të padrejta gjyqësore duke i shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe jomateriale, përfshirë dëmtimin e reputacionit.

Sipas vendimit, KGjK-ja në përgjigjen e saj ka theksuar se nuk e konteston bazën për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, por vetëm lartësinë e kompensimit të dëmit për shkak të qëndrimit në paraburgim dhe arrest shtëpiak, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë e konteston në tërësi si të pabazuar.

KGjK-ja, sipas vendimit, i ka ofruar Limajt kompensim për qëndrim në paraburgim prej 1 425 euro dhe për arrest shtëpiak shumën prej 5 mijë e 760 euro.

E paditura KGjK-ja ka kërkuar nga gjykata që shumën prej 717 mijë e 699 euro e 37 centë t'ia refuzojë, me arsyetimin se shpenzimet e përcaktuara për avokat janë të parapara me tarifë e që nuk kapin shumën në fjalë.

Më pas, gjykata, pas administrimit të provave, ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se paditësi Limaj ishte akuzuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për veprat penale: "Krime lufte kundër popullatës civile dhe robërve të luftës" dhe "Krime lufte kundër robërve të luftës".

Kontestues, sipas gjykatës, nuk ishte as fakti se paditësi kishte qëndruar nën masën e paraburgimit për gjithsej 104 ditë nga data 24 nëntor 2012 deri më 8 mars 2013, si dhe nën masën e arrestit shtëpiak për gjithsej 384 ditë. Dhe se nuk ishte kontestues mes palëve fakti i qëndrimit në paraburgim për periudhën e lartcekur vërtetohet edhe nga vërtetimi i datës 8 mars 2013 i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Por, sipas vendimit të Themelores, kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kompensimit të dëmit material dhe jomaterial për paditësin, po ashtu edhe baza e kërkesëpadisë sa i përket kërkesës së paditësit për kompensimin e dëmit material në raport me shpenzimet e tij për avokatin mbrojtës gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Gjithnjë sipas vendimit, Gjykata e Qarkut me vendimin e 2 majit 2012 kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj Limajt, i cili ngarkohej për "Krime lufte kundër popullatës civile dhe robërve të luftës" dhe "Krime lufte kundër robërve të luftës".

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 17 shtator 2013, pas procedurës penale në rigjykim, paditësi ishte shpallur i pafajshëm sërish për të gjitha pikat e aktakuzës.

Edhe Apeli më 26 janar 2016 e kishte vërtetuar aktgjykimin e Themelores, kurse Gjykata Supreme më 12 maj 2017 kishte refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj aktgjykimit të Apelit.

Sipas gjykatës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 29, paragrafi 5, ka rregulluar që: Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.

Në vendimin e saj, Gjykata Themelore ka përmendur rastin e Vasilevskiy dhe Bogdanov kundër Rusisë (2018) lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, ku është shprehur qëndrim se detyra e vlerësimit të dëmit që duhet dhënë personit si kompensim është e vështirë, sidomos kur kemi të bëjmë me një rast kur janë në shprehje të drejtat personale, si dhe vuajtja, qoftë fizike apo mendore, është objekt i kërkesës për kompensim. Po ashtu, në atë vendim është thënë se është konstatuar nga GjEDNj-ja se nuk ka ndonjë standard me të cilin dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë saktësisht të matshme të parave.

Gjykata Themelore në Prishtinë më tej ka vënë në dukje se e drejta për kompensimin e personave të paraburgosur pa të drejtë rregullohet edhe me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Gjykata ka gjetur se kompensimi për dëmin jomaterial është parim i ndërtuar ligjor që personave të akuzuar sipas aktit akuzues, të cilët gjatë zhvillimit të procedurës janë privuar nga liria, iu takon e drejta e kompensimit për shkak të privimit pa arsye nga liria.

Andaj, gjykata ka caktuar kompensimin në emër të dëmit jomaterial për 104 ditë të qëndrimit në paraburgim dhe 384 ditë të qëndrimit në arrestin shtëpiak, në shumën prej 100 eurosh për një ditë, e në total në emër të dëmit jomaterial shumën prej 48 mijë e 800 euro.

Shumën për dëmin jomaterial kjo gjykatë ka thënë se e ka caktuar sipas bindjes së lirë duke pasur si orientim kriteret dhe masat e vëna nga praktika gjyqësore lidhur me lartësinë e dëmeve materiale dhe jomateriale, si dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Për dëmin material, Gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për kompensimin e shpenzimeve që i ka pasur si pasojë e angazhimit të avokatëve të tij mbrojtës gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Andaj, e ka obliguar KGjK-në t'ia paguajë 6 mijë e 216 euro.

Po ashtu, e paditura detyrohet që paditësit në emër të pakove ushqimore gjatë qëndrimit në paraburgim t'ia paguajë shumën prej 150 eurosh, për faktin se kjo shumë paditësit i është pohuar edhe nga pala e paditur me rastin e dhënies së ofertës për ujdi jashtëgjyqësore në emër të pakove ushqimore.

Ndërsa Gjykata Themelore ka refuzuar që t'i paguhet shuma prej 2,951,200 eurosh si dëm jomaterial, me arsyetimin se aprovimi përtej shumës mbi 48 mijë euro nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur.

Sa i përket kërkesës për kompensimin e dëmit material, gjykata ka refuzuar shumën prej 710.433.37 eurosh pasi, sipas vlerësimit të Gjykatës, paditësi nuk ka argumentuar se është krijuar baza juridike për kompensimin e kësaj shume të kërkesëpadisë sa i përket kompensimit të dëmit material.

Sipas Themelores, angazhimi i avokatit ndërkombëtar nga ana e Limajt ka qenë në interesin e tij më të mirë, por angazhimi i tij me çmime të përfaqësimit shumë më të larta sesa ato të përcaktuara me rregulloren për tarifat e avokatëve të Kosovës, nuk mund të ketë pasoja për derivimin e përgjegjësisë ndaj të padituruës për kompensimin e tërësisë së shumës që paditësi ka paguar për mbrojtësin, përderisa në Kosovë ka ekzistuar rregullativë që rregullon çmimet e përfaqësimit të avokatëve mbrojtës.

Gjykata ka refuzuar shumën prej 900 eurosh për kompensimin për pakot ushqimore lidhur me kohën e qëndrimit në paraburgim, me arsyetimin se nuk janë argumentuar këto shpenzime.

Në fund të vendimit, Gjykata ka sqaruar se paditësit Limaj do t'i paguhet shuma e aprovuar me kamatë ligjore prej 8 përqindësh nga dita e marrjes së aktgjykimit më 20 qershor 2025 e deri në përmbushjen definitive për dëmin jomaterial, ndërsa për atë material prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë më 13 korrik 2017 e deri në pagesën definitive.

Në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, Themelorja ka obliguar të padituruën që paditëses t'ia kompensojë 2 048 euro e 8 centë. Shumat e kompensimit, përfshirë me kamatën ligjore, do të paguhen pasi që vendimi të bëhet i plotfuqishëm. Në fund, Gjykata ka njohur të drejtën e ankesës për palët e pakënaqura në afat prej 15-ditësh pasi palët ta marrin vendimin në formë të shkruar.

Kryeprokurori Isufaj dhe përfaqësuesit e Ambasadës së Britanisë diskutojnë për themelimin e ekipeve të përbashkëta hetimore

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, ka pritur të mërkurën në takim Margaret Belof, Alan Edwards, Altina Besimi dhe Blend Zyrapi nga Ambasada e Britanisë së Madhe në një takim pune.

Takimi është zhvilluar në kuadër të projekteve dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Ambasadës së Britanisë dhe Prokurorisë Speciale.

Gjatë takimit është vënë theksi te rëndësia e themelimit të ekipeve të përbashkëta hetimore, në përputhje me dispozitat e Ligjit të ri për Prokurorinë Speciale, si një hap i rëndësishëm drejt rritjes së efikasitetit në hetimin dhe ndjekjen e veprave të rënda penale.

Palët kanë theksuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit, ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe forcimit të raporteve ndërinsitucionale në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

KOSOVA NDAN 580 MIJË EURO PËR SHKOLLËN E MUZIKËS DHE MUZEUN E PRESHEVËS

PRISHTINË, 9 KORRIK - Qeveria në detyrë e Kosovës ka ndarë të mërkurën mbi gjysmë milioni euro për mbështetje financiare në bashkëfinancimin e projektit të ndërtimit të shkollës së muzikës dhe muzeut të Preshevës, komunë e banuar me shumicë shqiptare në Serbi. Gjatë takimit të kabinetit qeveritar, ministri në detyrë i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka thënë se ky vendim ka ardhur pas kërkesës së komunës së Preshevës. Ai ka thënë se kjo kërkesë është bazuar në marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginën e Preshevës.

Bashkëfinancimi i projektit në vlerë prej 580 mijë eurosh nga Kosova, sipas Çekut, përfaqëson "një ndër investimet më të rëndësishme për jetën kulturore të shqiptarëve në Luginën e Preshevës".

Siç është thënë më herët nga ekzekutivi i Kosovës, shteti i Kosovës deri më tani, përmes Këshillit Kombëtar Shqiptar, ka përkrahur 28 projekte të kulturës, ndërsa drejtpërdrejt përmes Ministrisë së Kulturës 21 projekte në Luginën e Preshevës – term që përfshin edhe Medvegjën dhe Bujanocin, komuna të banuara me shumicë shqiptare në jug të Serbisë.

Më 27 qershor janë ndarë 626 mijë e 400 euro për mbështetjen e arsimit dhe lobimit institucional për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, duke përfshirë bursa për studentë, mbështetje për nxënësit dhe financim të aktiviteteve lobuese e avokuese në nivel ndërkombëtar.

Në tetor të vitit të kaluar zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, ka akuzuar Serbinë se po përpiqet ta ndalojë mbështetjen financiare të Qeverisë së Kosovës për bujqit shqiptarë në Luginën e Preshevës.

Reagimi i Bislimit ka ardhur pasi përfaqësues të shqiptarëve nga Lugina e Preshevës thanë se Ministria për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave në Serbi kishte kërkuar anulimin e thirrjes për subvencionimin e kulturave bujqësore nga fondet e Qeverisë së Kosovës.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, e shpallur në vitin 2008, dhe e konsideron atë pjesë të territorit të saj.

Nga ana tjetër, autoritetet zyrtare në Beograd financojnë përmes buxhetit të Serbisë të gjitha institucionet arsimore dhe shëndetësore në zonat me shumicë serbe në Kosovë. Pjesa tjetër e institucioneve të Serbisë në Kosovë është mbyllur gjatë vitit 2024 nga autoritetet e Kosovës, pasi këto konsiderohen të paligjshme dhe paralele.

Kurti premton mbi 600 mijë euro investime në xhaminë e Sudi Efendisë në Prishtinë

PRISHTINË, 9 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, zakonisht viziton xhami të ndryshme në prag fushatash. Njëjtë ka bërë edhe të mërkurën, pak muaj para zgjedhjeve lokale. Kurti ka premtuar një investim prej mbi 600 mijë eurosh në Xhaminë e Sudi Efendisë në qendër të Prishtinës, për të cilën ka thënë se është në gjendje të keqe e pa kujdes institucional. "E ndërtuar fillimisht si mesxhid gjatë shekullit XVI, e më pas si xhami gjatë shekujve XVIII dhe XIX, Xhamia e Sudi Efendisë në qendër të Prishtinës, për një kohë të gjatë është lënë në gjendje të keqe fizike, pa kujdesin institucional, me lokale e ndërtime të larta përreth që ia kanë marrë vëmendjen që meriton dhe hapësirën që i takon. Por ajo tashmë e ka vëmendjen tonë. Nga sot nisën punimet për restaurimin e saj, që parasheh konsolidimin e strukturës së xhamisë, largimin e lokaleve rrotull dhe në fund rikthimin e saj në shfrytëzim nga komuniteti i besimtarëve mysliman. Ky projekt është përzgjedhur si projekt prioritar për restaurim, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Bashkësisë Islame të Kosovës. Vlera e investimit nga Ministria e Kulturës është 639,776.36 euro", ka shkruar Kurti në rrjetet sociale.

RRITET PAPUNËSIA E TË RINJVE ME ARSIM TË LARTË NË SHQIPËRI

TIRANË, 9 KORRIK - Vështirësitë për punësimin e të rinjve me arsim të lartë janë rritur ndjeshëm më 2025 në Shqipëri. Të dhënat e INSTAT-it në lidhje me papunësinë e të rinjve tregojnë se në tremujorin e parë të vitit 2024 shkalla e përgjithshme e papunësisë te grupmosha 15-24 vjeç ishte 24.0 për qind, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2025 ajo ka rënë në 22.3 për qind, por te te të rinjtë me arsim të lartë norma e papunësisë erdhi në rritje.

Në vitin 2024 ky grup kishte shkallën më të ulët të papunësisë, 18.6 për qind, por më 2025 ajo është rritur në 22.9 për qind, duke tejkaluar edhe ata me arsim bazë dhe të mesëm. Kjo rritje sugjeron një përkeqësim të ndjeshëm në mundësitë e punësimit për të rinjtë e diplomuar në universitet si pasojë mbingopjes me diploma në disa fusha, mospërputhjes me nevojat e tregut të punës apo mungesës së programeve efektive të integrimit profesional.

Për të rinjtë me arsim 8/9-vjeçar, shkalla e papunësisë është rritur nga 19.8 për qind në 2024 në 22.1 për qind në 2025.

Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se personat me arsimim bazë kanë pasur më pak mundësi punësimi krahasuar me një vit më parë. Një rritje e tillë po reflekton zhvendosje të kërkesës së tregut të punës drejt punonjësve më të kualifikuar ose dobësimin e sektorëve që zakonisht punësojnë fuqi punëtore më pak të arsimuar.

Ndërkohë, për të rinjtë me arsim të mesëm, papunësia ka pësuar rënie të ndjeshme nga 28.5 për qind në 22.1 për qind. Ky është një ndryshim pozitiv, që e vendos këtë grup në të

njëjtin nivel papunësie me ata me arsim bazë.

Ulja e fortë e papunësisë për këtë kategori tregon që individët me arsim të mesëm kanë përfituar nga një përmirësim i tregut të punës, ndoshta si rezultat i një rritjeje të kërkesës për punonjës me trajnim teknik apo profesional.

Të dhënat e tregut të punës për të rinjtë tregojnë ulje të përgjithshme të papunësisë, por me tendenca të ndryshme sipas nivelit të arsimit. Ndërsa ata me arsim të mesëm kanë përfituar më shumë nga përmirësimi i tregut të punës, ata me arsim të lartë përballen me sfida të reja që kërkojnë vëmendje të veçantë nga politika publike dhe sistemi i arsimit të lartë, raporton "Monitor".

Papunësia e të rinjve me diploma është një sinjal i keq për vendin, pasi përvoja ka treguar se shumë prej tyre, në vend që të përpiqen ta ndërtojnë jetën në vendin e tyre, zgjedhin të emigrojnë. Largimi i të rinjve është përforcuar edhe më shumë pas pandemisë dhe kjo është alarmante në kohën kur numri i tyre po ulet me shpejtësi.

Grupmoshat e reja të popullsisë tonë po tkurren me ritme rekord më shumë se kudo tjetër në Evropë. Nga viti 2011 në vitin 2023 grupmosha 0-29 vjeç është reduktuar me 44 për qind sipas të dhënave nga censet.

Mosha mesatare në Bashkimin Evropian në janar 2025 ishte 44.7 vjeç, ndërsa në Shqipëri, sipas të dhënave të INSAT-it, mosha mesatare e popullsisë ishte 44.3 vjeç, ndërsa më 2015 mosha mesatare në Shqipëri ishte 27.2 vjeç.

DHTIK-U I KËRKON AVOKATIT TË POPULLIT NISJEN E HETIMIT PËR BLLOKADËN E AUTOMJETEVE TË BIZNESEVE

PRISHTINË, 9 KORRIK - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë (DhTIK) ka njoftuar se ka kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit t'i nisë hetimet në lidhje me bllokadën që Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) dhe Policia e Kosovës ua kanë bërë një numri të madh të bizneseve sa i përket regjistrimit të automjeteve.

Në reagimin e DhTIK-ut është thënë se ka pranuar ankesa të shumta nga anëtarët e saj lidhur me zbatimin e një paragrafi të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, respektivisht neni 89, paragrafi 4, i cili ka filluar të zbatohet nga Policia e Kosovës, sipas të cilit, ndalohet regjistrimi i çdo automjeti të një subjekti juridik nëse ekziston qoftë edhe një gjobë e papaguar për ndonjë automjet tjetër në pronësi të të njëjtit subjekt. "Kjo praktikë ka filluar të zbatohet më datë

31.05.2025 nga Policisë së Kosovës, me ç'rast bizneset që kanë gjoba të papaguara, nuk po mund t'i regjistrojnë veturat e tyre pa i paguar të gjitha gjobat, pavarësisht se cili automjet është ndëshkuar, dhe kjo po ndikon në funksionimin normal të bizneseve, qarkullimin ekonomik dhe të drejtën për ushtrim të veprimtarisë së tyre", është thënë në reagimin e DhTIK-ut.

Më tutje, DhTIK-u ka vlerësuar se me këto veprime është shkelur Neni 46, paragrafi 1 i Kushtetutës së Kosovës, i cili përcakton se e drejta e pronës është e drejtë e garantuar. Pra, zbatimi i Ligjit nr 08/l-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor, neni 89, paragrafi 4, i pamundëson pronarit të pronës, qasjen dhe shfrytëzimin e pronës, duke e bllokuar dhe pamundësuar shfrytëzimin e pronës së tij.

"Zyrtarët policorë e kanë mbështetur këtë praktikë në nenin 89 të Ligjit Nr. 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, i cili rregullon ekskluzivisht ndalesat e parkimit të automjeteve në vende të caktuara dhe masat që ndërmerren kur shoferi nuk i përgjigjet thirrjes së Policisë me ç'rast konsiderojmë se është vendosje arbitrare e paragrafit 4 në nenin tematikisht të kufizuar. Paragrafi 4 i nenit 89 është futur në mënyrë të pa konsultuar dhe të pakoordinuar në një nen që ka për objekt vetëm ndalesat e parkimit. Kjo përbën një kontrabandim normativ që krijon pasiguri ligjore dhe hap rrugën për interpretime të rrezikshme në praktikë", është thënë në reagimin.

Sipas DhTIK-ut, "kjo praktikë po pamundëson regjistrimin e automjeteve që nuk kanë asnjë gjobë, duke bllokuar qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve dhe angazhimeve kontraktuale". "Si pasojë, bizneset po pësojnë humbje të drejtpërdrejta financiare dhe po cenohen në të drejtën për të ushtruar aktivitetin e tyre. Gjithashtu kjo praktike ndikon drejte për së drejti në rritjen e numrit të veturave të paregjistruara në trafik. Edhe në takimin e mbajtur muajin e kaluar me ARC-në dhe Policinë e Kosovës, Dhoma ka rekomanduar që të bëhet pezullimi i menjëhershëm dhe rishikimi i interpretimit të Nenit 89 në përputhje me qëllimin dhe objektin e tij ligjor", është thënë në reagimin e DhTIK-ut.

Qeveria ndan mbi 5 milionë euro për zhvillim rajonal, kulturë dhe punësim

PRISHTINË, 9 KORRIK - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhjen e 264-t, gjatë së cilës ka miratuar vendime për investime në infrastrukturë, arsim, kulturë dhe punësim.

Në këtë mbledhje është marrë vendimi për rialokimin e 1.2 milion eurove për dhjetë projekte kapitale në komunën Dragash, Ferizaj, Gjakovë, Han i Elezit, Klinë, Mitrovicë, Podujevë, Shtime, Prizren dhe Mamushë. Ky financim vjen në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal 2025, me synim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar social e ekonomik në të gjitha rajonet e vendit.

Qeveria ka miratuar edhe nismën për lidhjen e një marrëveshjeje granti në vlerë prej një milion dollarësh me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim. Ky grant do të shërbejë për përgatitjen e projektit "Nxitja dhe levimi i mundësive për sigurinë e ujit – faza 2", që do ta ndihmojë Kosovën në ndërtimin e një kornize kombëtare për sigurinë e digave. Projekti do të zbatohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ndër të tjera, qeveria ka aprovuar edhe kërkesën e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për të transferuar 712 mijë e 215 euro për mbulimin e obligimeve ndaj Federatës së Volejbollit dhe Komitetit Olimpik të Kosovës, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet palëve.

Në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë ndarë edhe dy milionë euro për mbështetjen e punësimit të qytetarëve nga komunitetet joshumicë në të gjithë vendin, përmes masës 1.9 që synon përfshirjen dhe

integrimin ekonomik të këtyre komuniteteve. Qeveria ka ritheksuar rëndësinë e vazhdimit të investimeve për zhvillim të barabartë dhe gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

TË GJITHË FAJIN E KA CULLUFJA E DONALD TRUMPIT

"Nëse hunda e Kleopatrës do të kishte qenë më e shkurtër, e gjithë faqja e Tokës do të kishte ndryshuar", shkruante Pascal, duke iu referuar faktit se një detaj në dukje i parëndësishëm mund të vendosë fatin e botës. Në bustin prej mermeri të ruajtur në Muzetë e Vatikanit, hunda mungon, është thyer, duke lënë hapësirë për imagjinatën. Por monedhat e kohës paraqesin profilin e saktë të mbretëreshës së fundit të Egjiptit.

A ishte bukuria e saj ajo që magjepsi Antonin dhe e çoi drejt shkatërrimit në betejën e Anzios, duke hapur kështu rrugën për mbretërimin e Augustit? Apo ndoshta Historia ndjek një trajektore të pandalshme, të pavarur nga tekat e rastësisë?

Kështu sugjeron, në fakt, teoria e "kurthit të Tukididit", sipas së cilës një fuqi dominuese përdor forcën për të frenuar një fuqi në ngjitje, deri në mundësinë ekstreme të luftës, siç ndodhi dikur mes Spartës dhe Athinës dhe siç ndodh sot mes Shteteve të Bashkuara dhe Kinës.

Ky dyshim, që ka ndezur debatet e brezave të tërë historianësh, shfaqet sërish sot përballë një figure kontroverse si Donald Trump, cullufja "e rebeluar" e të cilit është kthyer në simbolin e një personaliteti narcisist, të aftë për të tronditur ekuilibrat botërorë. A mund të shpjegojmë vërtet rrjedhën e Historisë me një dashuri të zjarrtë orientale apo me një tufë flokësh të kursyer nga gërshërët e berberit? Apo ndoshta shfaqja e Trump-it nuk është një ngjarje e rastësishme, por rezultati i domosdoshëm i forcave ekonomike dhe gjeopolitike që përplasen në kohën tonë? Në këtë kontekst mjafton të kujtojmë se tridhjetë vjet më parë, Shtetet e Bashkuara realizonin 20,2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto të botës (me barazi fuqie blerëse) dhe Kina vetëm 4,9 për qind, ndërsa në vitin 2024 Kina ka arritur në 19,5 për qind dhe SHBA kanë rënë në 14,9 për qind. Eksporti kinez është rritur në këto tridhjetë vjet nga 2,8 në 14,6 për qind të totalit botëror, ndërsa ai amerikan ka rënë nga 11,8 në 8,5 për qind.

Përballen kështu dy koncepte të ndryshme të Historisë. Sipas një lloj determinizmi historik, lideri amerikan nuk është tjetër veçse një gur loje brenda një tabloje që e tejkalon atë. Humbja e primatit ekonomik dhe teknologjik nga Uashingtoni, dhe pasojat e ndjenjave të mërzisë sociale, kanë bërë të pashmangshme ngjitjen e këtij manjati, i cili është zhveshur kështu nga çdo përgjegjësi personale direkte. Ka pararendës të rëndësishëm të kësaj ideje: Hegeli besonte se "dinakëria e arsyes" ishte vënë në shërbim të ambicies së Napoleonit, për të realizuar qëllimin e vet: fundin e ancien régime dhe përhapjen në Evropë të të drejtës borgjeze.

Shkolla e dytë e mendimit vendos përpara vullnetin e lirë dhe refuzon idenë e pashmangshmërisë së historisë. Trocki shkruante, në kujtimet e tij, se kishte marrë një ftohje të keqe në vjeshtën e vitit 1923, gjatë një gjuetie për rosat e egra. Ajo sëmundje sezonale e mbajti përkohësisht larg grindjeve politike në një moment vendimtar të përplasjes me Stalinin: një detaj në dukje i parëndësishëm që, për shkak të vdekjes së papritur të Leninit, e privoi atë nga drejtimi i Bashkimit Sovjetik. Mund të themi pra se, po të mos kishte ndodhur kriza ekonomike dhe kriza politike e Republikës së Vajmarit, e prekur nga inflacioni galopant, papunësia e lartë, dhuna nëpër qytete, në një Gjermani të rrënuar nga ndjenja e fajit moral pas katastrofës së Luftës së Parë Botërore, presidenti Hindenburg, plak dhe i sëmurë, mund të kishte vepruar ndryshe në janarin e vitit 1933, duke mos emëruar kancelar të Rajhut një njeri që, me obsesionet e tij maniakale, do ta tërhiqte botën drejt humnerës.

Në mënyrë të ngjashme, rënia e besimit në perspektivat amerikane nuk mjafton për të shpjeguar gjithçka: zgjedhjet e Trump-it – tarifat dhe qëndrimet e paqarta ndaj krizave si ajo në Ukrainë apo Palestina – kanë rëndësi, dhe me to vjen edhe përgjegjësia morale.

Të dyja qasjet ndaj historisë kanë kufizimet e tyre. Determinizmi mund të çojë në një fatalizëm: sikur historia të ishte një skenar i shkruar më parë, nuk mund të gjykojmë veprimet e Genghis Khanit apo Atilës? Nga ana tjetër, të konceptosh historinë si një zinxhir ngjarjesh të rastësishme çon në cinizëm: ndjejmë se jemi në mëshirë të rastit, si të varej e ardhmja nga një hundë e theksuar apo një cullufe flokësh të shprishur.

Filozofët Karl Popper, kritik i ashpër i "mjerimit të historizmit," dhe Isaiah Berlin, që tallej me 'pashmangshmërinë historike', na kanë paralajmëruar për rrezikun e tezave që zhdukin përgjegjësinë individuale. Historiani i madh britanik Edward H. Carr, duke polemizuar me të dy, kërkoi një rrugë të mesme, duke pohuar se Historia varet nga proceset e mëdha strukturore, jo nga 'njeriu i madh' i çastit – megjithëse edhe ai pranon rolin e ngjarjeve rastësore: detyra është të identifikojmë shkaqet themelore që lëvizin ingranazhet.

Ndoshta mënyra se si e shohim Historinë ndryshon sipas klimës së kohës që jetojmë. Historianët e antikitetit si Herodoti dhe Polibi thjesht rrëfenin kronikat (res gestae) për të nxjerrë mësime nga pasionet njerëzore (lakmia, zemërimi, heroizmi), të dobishme për të lexuar të tashmen, pa kërkuar një kuptim përfundimtar të historisë.

Vetëm me iluministët e shekullit XVIII lindi historiografia moderne (historia rerum gestarum) dhe një filozofi e historisë. Volteri, Montesquieu dhe Condorcet, të dehur nga liria pas dy shekujve tirani, kishin një besim të palëkundur në përparimin e njerëzimit të udhëhequr nga arsyeja, dhe shihnin në të kaluarën rrugën e bërë drejt çlirimit nga skllavëria. Për Hegelin, historia ishte përparimi i vetëdijes mbi lirinë, që arrin kulmin në Shtetin modern. Sipas vizionit eskatologjik të Marksit, fundi i Historisë është ardhja shpëtuese e një shoqërie pa klasa. Edhe historianët viktorianë të shekullit XIX, në kulmin e lavdisë së Perandorisë Britanike, shihnin në histori një vizion teleologjik. Por sot vështrimi ynë është krejtësisht i ndryshëm.

Nuk jemi më në kulmin e lavdisë, jetojmë në një Perëndim të përçarë dhe në krizë identiteti, që e ndien rënien e tij. Si pasojë, edhe sistemi ynë i vlerave po ndryshon. Na vjen gjithnjë e më vështirë të gjejmë fillin që të na udhëheqë në histori, një horizont që të na orientojë hapat. Prandaj edhe një tufë flokësh e shprishur nuk është më një detaj grotesk, por një simbol ringritjeje që një pjesë e Amerikës ka nisur ta vlerësojë.

Jo sepse berberi nuk arriti ta presë, por sepse vlerat e shoqërisë liberale – multikulturalizmi, multilateralizmi, madje edhe tregu i lirë dhe vetë demokracia – janë konsumuar në fushën e zhgënjimit. Prandaj jemi më të prirur të besojmë se Historia nuk udhëhiqet më nga ligjet e progresit, por bindemi se ajo është një fushë betejash të përjetshme.

Nëse historia vendoset nga një hedhje zari, atëherë jo vetëm hunda e Kleopatrës, por edhe tufëza e cullufja Trump-it mund të ndryshojë fatin e botës.

Sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova pëson nga Azerbajxhani

Kosova u mund nga Azerbajxhani në FIBA U18 EuroBasket 2025, Divizioni B, me rezultat 62:54 (15:11, 17:14, 10:15, 20:14). Ndeshja filloi dhe u zhvillua e baraspeshuar për të dy përfaqësueset, ku dy çerekët e parë u mbyllën me rezultat të ngushtë 15:11 dhe 17:14 në favor të Azerbajxhanit. Në periudhën e tretë Kosova u rikthye dhe e fitoi çerekun me rezultat 10:15, mirëpo në pjesën e fundit Azerbajxhani reagoi, u mbrojt më mirë dhe e fitoi çerekun me rezultat 20:14. Azerbajxhani e fitoi ndeshjen me rezultat përfundimtar 62:54. Me këtë ndeshje Kosova përfundoi garat në grupe, ndërsa tani do të luajë për vendet 17-21 në Evropianin, që po zhvillohen në Lituani.

NIS EVROPIANI I ESPORTS NË KOSOVË, KURTI: NGJARJE E MADHE, TA MBËSHTESIM ME ZEMËR EKIPIN TONË

"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 KORRIK - 36 ekipe nga 24 shtete të Evropës do të marrin pjesë në Kampionatin Evropian të Esports që ka nisur të mërkurën në Prishtinë, ndeshjet e të cilit zhvillohen në Palestrën e Sporteve "1 Tetori". Kosova jo vetëm që do të jetë mikpritëse e kësaj gare madhore, por edhe do të përfaqësohet me ekipin e saj kombëtar.

Në ceremoninë e hapjes zyrtare kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, të pranishmëve iu drejtua në gjuhën angleze. Ai theksoi se megjithëse në botë ky njihet si sport i ri, Kosova ka një storie të gjatë në këtë aktivitet pasi që të rinjtë e Kosovës shumë vjet më parë filluan angazhimin e tyre në lojërat elektronike nëpër internetkafe, duke bërë kështu hapat e parë drejt rritjes profesionale në këtë sport. "Sigurisht, si në çdo ngjarje tjetër sportive, fitorja ka rëndësi. Secili atlet ka ndjekur përsosmërinë me pasion dhe përkushtim. Por fuqia e vërtetë e këtij kampionati jeton përtej tabelës së rezultateve, por në lidhjet që ndërtojmë, historitë që ndajmë dhe komunitetin që krijojmë së bashku", u shpreh ai.

Kryeministri theksoi se Kosova është një vend ku talenti rritet me shpejtësi dhe se të rinjtë tanë mishërojnë fuqinë e vizionit dhe përkushtimit. Shtoi se aftësitë dhe pasioni i tyre si në sport ashtu edhe në teknologji krijojnë një themel të fortë, duke i bërë Esportet një shprehje natyrale të shpirtit dhe potencialit të vendit tonë. "Kampionati Evropian, Kosova 2025, qëndron si një moment i rëndësishëm - jo vetëm në Esports, por në atë që përfaqëson për rajonin tonë dhe më gjerë. Këtu, në këtë skenë, ne dëshmojmë se si lojtarë nga vende dhe prejardhje të ndryshme bashkohen nga një qëllim i përbashkët, të nxitur nga respekti dhe puna në grup. Kjo është pikërisht ajo që i duhet botës sot: unitet që ngrihet mbi kaosin, përpjekje të përbashkëta që ngrihen mbi kufijtë individualë dhe ide që ndërtojnë ura në vend të mureve", ka deklaruar kryeministri.

Ndeshja hapëse e Kampionatit Evropian të Esports ka qenë ajo në mes të Kosovës dhe Çekisë në Counter-Strike 2. Kjo ndeshje u ka takuar "Dardanëve" të cilët kanë fituar pa shumë vështirësi me rezultat 2-0.

SHKURT

Besa Famgas fillon prej raundit të parë, Rahoveci e Kastrioti prej të dytit

Kampioni i Kosovës, Rahoveci, fituesi i Kupës, Kastrioti, dhe finalistja e Kupës, Besa Famgas, paraqiten në Kupën Evropiane (EHF European Cup) për hendbollistë. Besa Famgas fillon prej raundit të parë. Shorti për këtë raund garash, njëjtë si për të dytin, është më 15 korrik. Ndeshjet zhvillohen më 6/7 dhe 13/14 shtator. Në raundin e parë janë gjithsej 18 ekipe, ndërsa skuadra pejane në short është bartëse. Rahoveci dhe Kastrioti janë në mesin e 64 skuadrave që paraqiten në raundin e dytë. Ndeshjet e raundit të dytë janë më 11/12 dhe 18/19 tetor. Në short, Rahoveci është bartës, ndërsa Kastrioti jobartës. Plot 73 skuadra paraqiten në Kupën Evropiane për hendbollistë.

Istogu bartës në short, tri skuadrat e tjera në vazon e dytë

Plot katër skuadra të Kosovës të hendbollisteve do të paraqiten në Kupën Evropiane (EHF European Cup). Të gjitha fillojnë prej raundit të dytë, ku gjithsej paraqiten 50 skuadra evropiane. Shorti tërhiqet më 15 korrik, ndërsa bartës në short është kampioni dhe fituesi i Kupës së Kosovës, Istogu. Në Kupën Evropiane paraqiten edhe nënkampionia, Samadrexha, finalisti i Kupës, Ferizaj, dhe Shqiponja e Gjakovës. Këto tri skuadra në short do të jenë në mesin e jobartësve.

Gjithsej 57 skuadra paraqiten në dy raundet e para të Kupës Evropiane. Shtatë skuadra fillojnë direkt prej raundit të tretë. Do të luhen nga dy ndeshje, një në shtëpi e një në udhëtim. 25 skuadrat më të mira të raundit të dytë kualifikohen në raundin e tretë. Ndeshjet e raundit të dytë janë më 27/28 shtator dhe 4/5 tetor.

Ramadani pas fitores ndaj Differdanges: Rezultati është pozitiv

Trajneri i skuadrës së Dritës, Zekirija Ramadani, ka vlerësuar paraqitjen dhe rezultatin e arritur në fitoren minimale 1-0 ndaj Differdanges, në ndeshjen e parë të raundit të parë kualifikues në Ligën e Kampionëve. "Rezultati është pozitiv. Goli erdhi me vështirësi. Kundërshtari u pa që ka disiplinë taktike. Nuk është rastësisht ekipi i vetëm në botë që nuk ka pësuar asnjë gol në ndeshjet në shtëpi. Ndeshja e parë, si për ne si për ata, presioni ishte në anën tonë. pamë që kishim përballë një kundërshtar cilësor. Jam i kënaqur me këtë rezultat dhe tani e kemi më të lehtë pasi mund ta analizojmë ndeshjen. Mund t'i përmirësojmë gabimet që i kemi bërë. Duhet të luftojmë më tepër se sonte. I kuptoj lojtarët që mund të jetë e vështirë, por duhet të luftojmë më tepër, të vrapojmë më tepër. Goli i shënuar mund të na ndihmojë të krijojmë hapësirë në mbrojtjen e kundërshtarit në ndeshjen e kthimit. Mund të jetë gol i kualifikimit", ka thënë Ramadani.

Pajaziti i lumtur që është bashkuar me Kosovën U19

Prishtinë, 9 korrik - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll (djemtë) po vazhdon përgatitjet për Kampionatin Botëror që muajin e ardhshëm mbahet në Egjipt. Emër i ri në përfaqësuese është Suad Pajaziti, që bën karrierë te OSF Berlin në Gjermani. Pajaziti luan në pozitën e alos së majtë, ndërsa ka shfaqur cilësi në pjesën e deritashme të përgatitjeve. "Më kanë pritur shumë mirë. Jam shumë i kënaqur. Çdo gjë po shkon mirë. Unë luaj në Gjermani, në Berlin. Pozita ime është alo e majtë", ka thënë Pajaziti për faqen zyrtare të FHK-së. Ai është i gatshëm për paraqitje në Botëror, ndërsa ka premtuar maksimumin. "Kemi pasur një ndeshje me Cottbusin, ku luan Bleron Imeraj. Kemi diskutuar dhe kam vendosur menjëherë ta pranoj mundësinë të luaj për Kosovën. Dhe tani jam këtu. Jam shumë i gatshëm për të shkuar në Botëror dhe të jap më të mirën për ta ndihmuar ekipin. Shpresoj në paraqitje sa më të mira", ka deklaruar Pajaziti.

Ismajli paraqitet te Torino

TORINO, 9 KORRIK - Ardian Ismajli është zyrtarisht futbollist i Torinos, me klubin "granda" që paraqiti mbrojtësin kuqezi në një mënyrë shumë origjinale, me simbolin e kombit tonë, shqiponjën. "Klubi i Torinos ka nderin të komunikojë se Ardian Ismajli është futbollisti ynë. Ismajli firmosi një kontratë deri më 30 qershor 2027, me opsion rinovimi edhe për një tjetër vit", thuhet në njoftimin e Torinos, ku nuk mungoi as CV e tij, një lojtar me shumë përvojë ku vetëm me fanellën e Empolit ka zhvilluar 106 ndeshje. Ismajli është një element shumë i rëndësishëm edhe i përfaqësues shqiptare ku me fanellën kuqezi ka zhvilluar 45 ndeshje dhe ka shënuar tri gola. "Përshëndetje tifozë granada! Jam i nderuar ta vesh fanellën e demave. Forca, dema!", ishte mesazhi i parë i Ismajlit drejtuar tifozëve të ekipit torinez.

Muriqi pasi vazhdoi kontratën me Mallorcan: Vendimi më i mirë i jetës sime

MALLORCA, 9 KORRIK - Mallorca dhe Vedat Muriqi kanë njoftuar zyrtarisht rinovimin e kontratës. Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës do të jetë pjesë e klubit të La Ligas deri në vitin 2029. Kjo është një shenjë e fortë e vazhdimësisë dhe njohjes së ndërsjellë midis lojtarit dhe spanjollëve. Pasi mbërriti në huazim në ishull në janar 2022, ai u ambientua shpejt dhe mori drejtimin e ekipit në një kohë vendimtare: Mallorca po luftonte për ta shmangur rënien nga La Liga, por falë shpirtit të tij luftarak dhe golave, ata arritën të qëndronin në ligë, dhe kështu ai më në fund u ble për kënaqësinë e madhe të tifozëve. Në tre sezone e gjysmë, qendërsulmuesi bëri 118 paraqitje, duke shënuar 35 gola dhe duke dhënë 11 asistime. Këto shifra mbresëlënëse demonstrojnë ndikimin e

vazhdueshëm dhe vendimtar të "Il Pirata", siç është njohur gjithmonë. "Mbi të gjitha, ndiej krenari dhe kënaqësi. Është një nder të vazhdoj ta jetoj këtë ëndërr me këta njerëz dhe të rritem me ta. Do të thotë shumë për mua. Të qëndroj këtu është padyshim vendimi më i mirë i jetës sime. Nuk do ta ndryshoj kurrë këtë ëndërr, sepse Mallorca është ëndrra më e bukur që kam pasur ndonjëherë", ka thënë Muriqi.

Red Bulli shkarkon drejtorin Christian Horner pas 20 vjetësh në krye të ekipit

MILTON KEYNES, 9 KORRIK - Pas dy dekadash të një karriere të suksesshme, por kohët e fundit të trazuar, në krye të Red Bull Racing, Christian Horner është liruar zyrtarisht nga detyrat e shefit të ekipit dhe drejtor ekzekutiv i gjigantit austriak të F1. Lajmi u konfirmua sot nga Red Bulli, dhe Laurent Mekies, ish-shefi i ekipit motër Racing Bulls, është emëruar pasardhësi i Hornerit. Horneri ka qenë një figurë kyçe në sukseset e Red Bullit që nga viti 2005, duke përfshirë tetë tituj për pilotë dhe gjashtë për konstruktorë, dhe duke krijuar një dominim që e ka ripërcaktuar vazhdimisht Formula 1. Megjithatë, viti i kaluar është shënuar nga polemika të shumta dhe një rënie në formë. Hetimi i brendshëm i vitit të kaluar mbi akuzat për

sjellje të papërshtatshme nuk rezultoi në sanksione, por tensionet brenda ekipit nuk u qetësuan. Kritikat erdhën nga shumë anë, përfshirë babanë e Max Verstappen, Jos, i cili vuri në dyshim publikisht menaxhimin e ekipit nga Horner. Kulmi i pakënaqësisë erdhi këtë sezon: Red Bulli ra në vendin e katërt në renditjen e konstruktorëve dhe kohezioni i ekipit, i cili kishte qenë shenja dalluese e ekipit për vite me radhë, u dëmtua seriozisht. "Christian Horner ka dhënë një kontribut të pashlyeshëm për Red Bull Racing. I jemi mirënjohës për të gjitha vitet e tij të përkushtimit, por ekipi ka vendosur se është koha për një kapitull të ri", thuhet në njoftimin zyrtar të ekipit.
Laurent Mekies (48), ish-drejtor sportiv i Ferrarit, i cili iu bashkua organizatës Red Bull vitin e kaluar përmes ekipit Racing Bulls, merr përsipër rolin e shefit të ekipit dhe drejtorit ekzekutiv. Në deklaratat e para, Mekies njoftoi tashmë "konsolidimin dhe energjinë e re" dhe njoftoi një riorganizim të brendshëm në mënyrë që ekipi ta rifitojë konkurrueshmërinë në pistë.

SHKURT

Sassuolo e Monaco pas Arijanet Muriqit

Portieri Arijanet Muriq ka gjasa reale të largohet nga Ipswich Town, ekip të cilit iu bashkua para një viti. Dy klube, njëri nga Seria A e Italisë dhe tjetri nga Liga 1 e Francës, kanë shprehur interesim për shërbimet e Muriqit. Sassuolo dhe Monaco janë ekipet që po insistojnë në transferimin e portierit 26-vjeçar këtë verë, i cili është i gatshëm të largohet nga Ipswichi, ekip që nuk ka mbijetuar në Premierë Ligë dhe në sezonin e ri do të bëjë gara në Championship. Madje thuhet se Sassuolo ka bërë ofertë zyrtare për portierin Muriq, ndërsa edhe Monaco ka kontaktuar Ipswichin dhe mbetet të shihet nëse do të arrihet ndonjë marrëveshje. Muriqi verën e shkuar iu bashkua Ipswichit nga Burnley dhe ka kontratë me skuadrën angleze deri në vitin 2028 dhe kartoni i tij vlerësohet 5 milionë euro. Sezonin e shkuar ai regjistroi 18 paraqitje në Premierë Ligë, kurse ka edhe 38 ndeshje për Kosovën.

Trumpi konfirmon se do të jetë i pranishëm në finalen e Botërorit të Klubeve

Presidenti amerikan Donald Trump ka konfirmuar pjesëmarrjen e tij në finalen e Botërorit të Klubeve që do të zhvillohet të dielën në "MetLife Stadium" të East Rutherford në New Jersey. Lajmi është raportuar nga ESPN, që citon deklaratën e Trumpit gjatë një mbledhjeje me kabinetin e tij. "Do të shkoj në ndeshje", ka thënë ai duke iu përgjigjur gazetarëve. Njoftimi i Trumpit vjen vetëm disa orë pasi FIFA bëri me dije për hapjen e një zyre përfaqësuese në "Trump Tower" në Manhattan. Pikërisht aty, deri të dielën, do të qëndrojë i ekspozuar edhe trofeu i Botërorit të Klubeve. Ky eveniment shihet si një provë gjenerale për organizimin e Kupës së Botës për Kombëtare, që do të mbahet vitin e ardhshëm në ShBA, Kanada dhe Meksikë. Pjesëmarrja e Trumpit në finalen e së dielës pritet të tërheqë shumë vëmendje si në aspektin sportiv, po ashtu edhe në atë politik.

Musiala: Nuk akuzoj askënd për atë që ndodhi

Jamal Musiala ka reaguar për herë të parë pas dëmtimit të rëndë që pësoi gjatë ndeshjes së Botërorit të Klubeve ndaj Paris Saint-Germainit. Përmes një mesazhi të publikuar në rrjetet sociale, Musiala falënderoi të gjithë për mbështetjen dhe bëri një koment indirekt edhe për Gianluigi Donnarumma, portierin e PSG-së, i cili në mënyrë krejtësisht të pavullnetshme shkaktoi përplasjen që solli dëmtimin. "Dua t'i falënderoj të gjithë për mbështetjen! Do të thotë shumë për mua. Është e bukur mënyra se si bota e futbollit bashkohet në momente të tilla. E vlerësoj shumë. Operacioni shkoi shumë mirë dhe ndihem mirë. Gjithashtu, dua të theksoj se nuk akuzoj askënd për këtë që ndodhi, situata të tilla ndodhin në futboll. Tani do të përdor këtë periudhë për t'u rikuperuar dhe për t'i rifituar forcat. Nuk shoh dot orën t'ju rikthehem", ka shkruar Musiala.
Futbollisti 21-vjeçar do të qëndrojë jashtë fushave për të paktën katër deri në pesë muaj për shkak të një frakture në fibulë dhe një dëmtimi të rëndë të ligamenteve në kyçin e këmbës.

Luis Diazi pranon transferimin te Bayerni

Sulmuesi anësor i Liverpoolit, Luis Diaz, thuhet se ka pranuar kalimin e tij në Bundesligë te gjiganti gjerman Bayern Munchen. Sipas gazetarit Christian Falk, Diaz ka shprehur dëshirën e tij për t'u bashkuar me Bayern Munichun, duke i dhënë klubit gjerman një shtysë të madhe në ndjekjen e tij. Bayerni tani është i bindur se do të përparojë në negociata me klubin anglez, pasi ka marrë dritën jeshile nga lojtari kolumbian. Gjigantët e Bundesligës po përgatitin një ofertë me vlerë deri në 60 milionë euro plus bonuse të lidhura me performancën. Ndërsa Liverpooli ende nuk ka marrë një ofertë zyrtare, klubi është në dijeni të interesit të Bayernit dhe do ta vlerësojë propozimin sapo të mbërrijë zyrtarisht. Për lojtarin e interesuar ishte edhe Barcelona, por gjiganti katalanas si duket ka kthyer sytë te ndonjë objektiv tjetër këtë verë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Helios Power SH.P.K (I autorizuar Shaban Cacaj) me nr. të protokolit 4173/25 të datës 26.05.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaike dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Junik, me numër të parcelave:
Junik P-73105038-05052-0, P-73105038-05053-3, P-73105038-05036-0, P-73105038-04169-10, P-73105038-04169-11, P-73105038-05173-6, P-73105038-05173-1 dhe P-73105038-0553-4 me sipërfaqe totale prej 852,850 m^2 që ndodhen në Komunën e Junikut.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaik "Parku Solar Juniku A dhe B" për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.21.07.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara: **Kushtet Ndërtimore të propozuara:** Helios Power SH.P.K. Deçan / Junik	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim: a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Mal i klasës 4,5 dhe 6 Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtritshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	**5.5 -** m'
c. Vija e ndërtimit.	**7** m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	**2.5-3.5 m**
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	**2.5 m** **3.5 m**
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	**6 %**
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**94 %**
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**-** **%**
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	**-** **%**
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	20
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Ar Beton" shpk, Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Zgjerimin e Shfrytëzimit të Inerteve në Lubozhdë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.08.2025 në ora 09:00 në Objektin e Shtëpisë të Kulturës, rr. "Skënderbeu", do të organizohet debat publik nga Kompania "Ar Beton" shpk, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Ar Beton" shpk, Istog, për Pëlqim Mjedisor, – për Zgjerimin e Shfrytëzimit të Inerteve në Lubozhdë, Istog.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "German Plast" shpk, Junik, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun Solar "German Plast" me kapacitet 9.20 MW në Junik.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.08.2025 në ora 11:00 në Objektin e SHFMU "Edmond Hoxha", Junik, do të organizohet debat publik nga Kompania "German Plast" shpk, Junik, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "German Plast" shpk, Junik, për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun Solar "German Plast" me kapacitet 9.20 MW në Junik.

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

KOLEGJI - COLLEGE BIZNESI Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të **Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:**

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës.
Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:
- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878

CREDINS bank

Nr. Prot. 1426

Prishtinë, më 04.07.2025

Në bazë të Nenit 24 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L-093 per Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, "Banka Credins Kosovë" Sh.a, publikon këtë:

NJOFTIM
PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË JASHTËZAKONSHME AKSIONARËVE TË "BANKA CREDINS KOSOVË" SH.A.

1. Thirrja e Mbledhjes të Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve është bërë sipas kërkesës të paraqitur nga Bordi i Drejtoreve "**BANKA CREDINS KOSOVË**" SH.A.

2. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve, do të mbahet nga distanca permes kycjes me platforma online qe banka ka vendosur ne dispozicion te pjesemarresve, më datë 09/07/2025 duke filluar nga ora 15.00.

3. Rendi i ditës:

i. Propozim per kompesimin e Kryetarit dhe Anetareve te Bordit te Bankes Credins Kosove

4. Ftohen aksionarët e shoqërisë, që të paraqiten në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve, në kohën e specifikuar në këtë njoftim.

5. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Banka CREDINS KOSOVË SH.A.

Shpend NURA
Kryeshef Ekzekutiv

BANKA CREDINS KOSOVË SH.A

KOLEGJI - COLLEGE BIZNESI Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi.**

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erza Noci nga Dujaka e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 të lëshuar nga shkolla fillore "Fan S. Noli", Dujakë.

Shqipe Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

Elza Jasiqi nga Hereqi i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U "Dëshmorët e Hereqit", Hereq, Komuna e Gjakovës.

Bleona Bobi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Gresa Krasniqi nga Gjakova, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES

100%
Fresh & Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË

ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L